



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Deportimi i shtetasve shqiptare nga vendet fqinjë

Të forcohet bashkëpunimi midis autoriteteve shqiptare dhe atyre të vendeve fqinjë, për të garantuar shëndetin dhe jetën e çdo shtetasi shqiptar të kthyer/dëbuar

Në kuadër të masave parandaluese të marra kundër pandemisë globale Covid-19, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) po monitoron me kapacitete të kufizuara, sjelljen dhe qëndrimet e autoriteteve publike dhe mënyrën se si këto masa ndikojnë në të drejtat dhe liritë ndaj shtetasve.

Më 22 Mars 2020, KShH u njoh me anë të medias me lajmin për deportimin nga Greqia të 24 shtetasve shqiptarëve, njëri prej të cilëve shfaqti simptoma të Covid-19.¹ Po ashtu, nga mediat bëhet e ditur se pala greke ka deportuar dhe 32 shqiptarë të tjerë. Arsyeja e deportimit rezulton cenimi prej këtyre shtetasve, i kriterëve dhe kushteve të qëndrimit në vendet e Bashkimit Europian dhe zonës Shengen.

Nga mediat rezulton se ndihma e parë mjekësore ju është vënë në dispozicion 24 të deportuarve, në momentin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në Pikën e Kalimit Kufitar Kakavijë. Nga pamjet filmike të ofruara nga media, KShH konstaton me shqetësim se udhëtimi i 24 shtetasve është realizuar në kushte të sforcuara, në mungesë të masave mbrojtëse si maska apo doreza. Shqetësues është fakti se pjesë e këtij grupi ka qenë një shtetas, i cili dyshohet se është mbartës i virusit Covid-19.

 ***Cenimi i standarteve dhe legjislacionit ndërkombëtar për mosmarrjen e masave mbrojtëse të shëndetit nga pala greke, gjatë dëbimit të shtetasve shqiptare***

Në praktikën gjyqësore ndërkombëtare, individët që i nënshtrohen dëbimit kanë kërkuar të kundërshtojnë vendimin përkatës, me arsyetimin se gjendja e tyre shëndetësore mund të përkeqësohet nga vetë dëbimi: Komiteti Kundër Torturës ka deklaruar në disa raste se një përkeqësim i tillë nuk është në llojin e trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues të parashikuar nga neni 16 i Konventës.² Por Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Strasburg) reflekton një praktikë më humane. Në çështjen ***Paposhvili kundër Belgjikës***, Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së argumentoi se: “*Ndikimi i largimit të personit duhet të vlerësohet duke krahasuar gjendjen e tij/e saj shëndetësore përpara*

¹ Burim: Report TV: <https://www.youtube.com/watch?v=WTgp4Djqk2c>

² G.R.B. v Sweden, CAT/C/20/D/83/1997, 15 May 1998, parag.6.7; B.S.S. v Canada, CAT/C/32/D/183/2001, 12 May 2004, parag.10.2; and S.S.S. v Canada, CAT/C/35/D/245/2004, 16 November 2005, parag.7.3

Address: Rr. Brigata e VIII,

Tel & Fax: ++355 (0)4 22

33671

Pll. Tekno-Projekt, Ap. 10, Tirana-Abania

P. O. Box /Kutia Postare No. 1752

e-mail: office@ahc.org.al

web address: www.ahc.org.al



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

procedurës së largimit, dhe se si kjo gjendje do të evoluojë pas largimit. Në këtë këndvështrim shteti depërtues duhej të merrte në konsideratë ndër të tjera: nëse kujdesi në përgjithësi i disponueshëm në shtetin pritës "është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm në praktikë për trajtimin e sëmundjes së aplikantit në mënyrë që të parandalojë që ai ose ajo të ekspozohet ndaj trajtimit në kundërshtim me Nenin 3; si dhe shkalla në të cilën në të vërtetë individi do të kishte akses në një kujdes të tillë në Shtetin pritës (kostot e shoqëruara, ekzistencën e një rrjeti social dhe familjar, dhe distancën që duhet të udhëtojë për të aksesuar në kujdesin e kërkuar, duke qenë të gjitha relevante në këtë drejtim".³

Në rastin e deportimit të shtetasve shqiptarë, autoritetet greke zotëronin të dhënat e mjaftueshme për të vlerësuar rrezikun që i kanosej këtyre shtetasve, duke vlerësuar distancën udhëtimit dhe për ti paraprirë kësaj gjendje duke pajisur këta shtetas me mjetet e nevojshme mbrojtëse, në raport me rrezikshmërinë e përhapjes së Covid-19 ndërmjet tyre. Mungesa e vlerësimit të riskut dhe veçanërisht mosmarrja e masave mbrojtëse, përveç se ka rrezikuar objektivisht shëndetin e shtetasit shqiptar të dyshuar i cili ka reflektuar shenja klinike, ka rrezikuar gjithashtu bashkëudhëtarët e tij ndaj mundësisë për infektimin, në kundërshtim me detyrimet e marra përsipër për garantimin e respektimit të protokolleve të miratuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Republika e Shqipërisë⁴ dhe ajo greke⁵ kanë ratifikuar Kartën Sociale Evropiane. Në nenin 11 të këtij akti është parashikuar e drejta për mbrojtjen e shëndetit, sipas të cilit shtetet anëtare duhet të marrin masat efektive për minimizimin maksimal të shkaqeve përkeqësuese të shëndetit, si dhe për të parandaluar sa më shumë të jetë e mundur epideminë, sëmundjet endemike dhe sëmundjet e tjera, si dhe aksidentet.

Mungesa e respektimit të standardeve ndërkombëtare cenon në mënyrë të pashmangshme frymën humanitare që përçon legjislacioni ndërkombëtar. Edhe në kohë lufte, nën zbatimin e Konventave të Gjenevës dhe protokolleve shtesë të tyre, shtetet kanë detyrimin e ndërmarrjes (në masën më të madhe praktike) veprimet për mbrojtjen e duhur dhe sigurinë e personave që do të largoheshin, me qëllim që kjo procedurë të kryhej në kushte të kënaqshme të higjienës, shëndetit, sigurisë dhe ushqimit.⁶

³ Papashvoli v. Belgium, Aplikim nr. 41738/10, dt. 13.12.2016.

⁴ Dt. ratifikimi 14/11/2002

⁵ Dt. ratifikimi 18/03/2016

⁶ Neni 49 i Konventës së 4të të Gjenevës në lidhje me mbrojtjen e personave civilë në kohën e luftës, 12 Gusht 1949.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Në respektim të së drejtës ndërkombëtare, parimit të reciprocitetit dhe konventave të ratifikuara, KShH tërheq vëmendjen e autoriteteve shqiptare lidhur me nevojën për të marrë masa që nxisin bashkëpunimin bilateral dhe rajonal sa më efektiv midis autoriteteve tona dhe atyre të vendeve fqinjë, me qëllim të maksimizohet garantimi i shëndetit të shtetasve të deportuar apo që kthehen në territorin e vendit tonë, në kushtet e kësaj pandemie globale.

Në respektim të udhëzimeve dhe protokolleve të OBSH-së, këto masa duhet të konsistojnë, ndër të tjerash, në vënien në dispozicion të maskave mbrojtëse, dorezave dhe ofrimin e medikamenteve antiinflamatorë, në momentin e konstatimit të shenjave klinike.